

**BASHKIA DURRES**  
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

PËR DHËNIEN ME QIRA TË PJESE TË PASURISË, ME ADRESË LAGJIA NR. 14, RRUGA “ASTI NUSHI”, E NDODHUR NË KATIN 0 (ZERO) TË NDËRTESES ME NR. PASURIE 5/109, ZK 8516, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 585.2 M<sup>2</sup> (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 555 M<sup>2</sup> DHE SIP. FUNKSIONALE 30.2 M<sup>2</sup>), NË INVENTAR TË NDËRMARRJES TREGTISË ME SHUMICË (BGT), PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 3 (TRE) VJET, NËPËRMJET PROCEDURËS SË KONKURRIMIT

1. Fillimi i procedurave për dhënie me qira të një pjese të katit 0 (zero) të ndërtesës me nr. pasurie 5/109, ZK 8516, me sipërfaqe të përgjithshme 585.2 m<sup>2</sup> (nga kjo sip. ndërtimi 555 m<sup>2</sup> dhe sip. funksionale 30.2 m<sup>2</sup>), me vendodhje Lagjia Nr. 14, Rruga “Asti Nushi”, në inventar të Ndërmarrjes Tregtisë me Shumicë (BGT), pronë e Bashkisë Durrës.

2. Qëllimi i përdorimit të ambjentit së bashku me truallin funksional të tij është për ushtrimin e aktiviteteve të të gjitha llojeve për njësi prodhimi, të cilat nuk krijojnë ndotje sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

3. Çmimi dysheme i fillimit të konkurrimit është 113,611 (njëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë) lekë/muaj, e përlogaritur kjo sipas VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfileozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

4. Afati i dhënies me qira do të jetë 3 (tre) vjet.

5. Pikët vlerësuese do të jenë:

Niveli i investimit	30 pikë
Niveli i punësimit	30 pikë
Oferta e detyrimit	40 pikë

6. Tërheqja e dokumentacionit të nevojshëm do të bëhet në zyrën e caktuar nga bashkia për pronat publike.

7. Dokumentacioni që do të paraqesin konkurrentët për marrjen me qira do të jetë si më poshtë:

a) Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë së Bashkisë Durrës, ku të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrencës, të parashikuar sipas planit të biznesit.

b) Planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:

- Identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen;
- Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;
- Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij;
- Niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara;
- Një përshkrim i hollësishëm të planit të biznesit.

c) Deklaratat në formën e vetëdeklarimit (bashkëlidhur), si më poshtë vijon:

- Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkues;
- Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

d) Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte, pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt, të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore.

dh) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.

8. Paraqitja e dokumentacionit do të kryhet pranë Bashkisë Durrës, kati i parë, zyra e Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, datë 19.7.2024, ora 10<sup>00</sup>.

## MODELI I VETËDEKLARIMIT

### DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

DEKLARATË E KONKURRUESIT PJESMARRËS NË PROCEDURËN E KONKURRIMIT PËR MARRJEN ME QIRA TË NJË PJESE TË PASURISË, ME ADRESË LAGJIA NR. 14, RRUGA “ASTI NUSHI”, E NDODHUR NË NË KATIN 0 (ZERO) TË NDËRTESESË ME NR. PASURIE 5/109, ZK 8516, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 585.2 M<sup>2</sup> (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 555 M<sup>2</sup> DHE SIP. FUNKSIONALE 30.2 M<sup>2</sup>), NË INVENTAR TË NDËRMARRJES TREGTISË ME SHUMICË (BGT), PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 3 (TRE) VJET, QË DO TË ZHVILLOHET NGA BASHKIA DURRËS ME DATË 19.7.2024, ORA 10<sup>00</sup>

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë \_\_\_\_\_ të subjektit \_\_\_\_\_, me NIPT / NUIS \_\_\_\_\_, adresë \_\_\_\_\_, me fushë veprimtarie \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Jam i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe kam në fushën e veprimtarisë \_\_\_\_\_.
- Kam paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.
- Nuk jam i dënuar për shkelje penale, në përputhje me pikën 7 dhe 8, të Kreut të II-të, të VKM –së nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.
- Nuk jam i dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë e aktivitetit.
- Nuk jam në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Nuk/ Ushtoj aktivitet në objekte shtetërore.

Deklaroj se mbaj përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim.

Autoriteti qiradhënës (bashkia Durrës) ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga ana ime.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
Vula